



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

Nr. 1512 / prot.
1

Tiranë më 17.10 2018

VENDIM

Nr. 56, datë 17.10.2018

PËR

RRËZIMIN E ANKESËS

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") Formularin e Ankesës nr. 1512 Prot., datë 11.10.2018, me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*", kundër Autoritetit Publik "Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale/ Drejtoria e Aluizni-t Tirana Veri", (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").

Ankuesi në cilësinë e kërkuarit, nëpërmjet kërkesës së datës 07.08.2018 ka kërkuar nga Autoriteti Publik t'i vihet në dispozicion dokumentacioni/informacioni i disponueshëm në lidhje me:

- *Praktikën e plotë për lejen e legalizimit dt. 19.06.2013, të lëshuar në emër të për objektin 3 katësh në Tiranë,*

Me shkresën nr. 8238/1prot., datë 28.08.2018 Autoriteti Publik i ka kthyer përgjigje kërkuarit duke argumentuar se ky i fundit nuk legjitimohet në kërkimin e tij, me arsyetimin se: "*Informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar nuk mund të vihet në dispozicion, pasi përmban të dhëna me karakter personal.*" Më tej autoriteti parashtron se: "*...mbrojtja dhe ruajtja e konfidencialitetit, për kategorinë e informacionit të kërkuar, është një detyrim ligjor i sanksionuar me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Për të disponuar këtë dokumentacion, kërkuari duhet të provojë legjitimitetin*".

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Zyrës së Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Vlen paraprakisht të theksohet se Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, rregullon njohjen me informacionin publik të administruar nga autoritetet publike në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së tyre, dhe në bazë të pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, “informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”. Megjithatë, dokumentet me karakter personal që mund të administrohen në një praktikë të caktuar të administruar nga autoriteti publik në kuadër të ushtrimit të detyrave apo kompetencave të tij nuk mund t’i nënshtrohen bërjes publike. Kjo në përputhje me kufizimet e së drejtës për informim të sanksionuar në nenin 17, pika 1, gërma a e Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosje (konkretisht me shkresën nr. 8238/1prot., datë 28.08.2018), Komisioneri konstaton se në momentin e aplikimit, kërkuesi nuk ka qënë në bashkësi ligjore me subjektin vetëdeklarues si dhe nuk rezulton që titullari i kësaj të drejte të ketë dhënë pëlqimin për bërjen publik të informacionit përkatës tek të tretë. Duke qënë se kërkuesi nuk rezulton të ketë provuar se gëzon titull pronësie apo tagrat e përfaqësimit ligjor, mbi këtë pasuri për të cilën kërkon informacion/dokumentacion, ai nuk legjitimohet në kërkimin e tij.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e z. kundër Autoritetit Publik “Agjencia e Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale/Drejtoria e Aluizni-t Tirana Veri”, Komisioneri vlerëson se informacioni nuk mund të vihet në dispozicion për shkak të kufizimit të arsyetuar më sipër.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”,

V E N D O S A:

1. Rrëzimin e ankimit nr. 1512 Prot., datë 11.10.2018 të z. , kundër Autoritetit Publik “Agjencia e Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale/ Drejtoria e Aluizni-t Tirana Veri”.
2. Kundër këtij vendimi, palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
3. Ky vendim u shpall sot në datë 17.10.2018.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

